



VENDIM

Nr. 142, datë 22.2.2017

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT
“STANDARDET SHTETËRORE PËR
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOPAPËSINOR
NË SHQIPËRI. TEMA: EMËRTIMET
GJEOGRAFIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 11, dhe të pikës 1, të nenit 16, të ligjit nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeopapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeopapësinor në Shqipëri. Tema: Emërtimet gjeografike”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeopapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave gjeopapësinore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



STANDARDET SHETËTËRORE PËR SPECIFIKIM ET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOPAPËSINOR NË SHQIPËRI. TEMA: EMËRTIMET GJEOGRAFIKE

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeopapësinore për ndërtimin e NSDI, duke u mbështetur në Direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeopapësinor (ASIG) në bashkëpunim me Institutin Gjeografik dhe Infrastrukturën Ushtarake (IGJIU), si dhe me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë (IGjL). Data e publikimit të versionit Nr. 1 është Tetor 2016. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSDI_2016_EGJ_v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2016 – Viti i krijimit

EGJ– Tema për të cilën është krijuar standardi: Emërtimet gjeografike

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1. SI LEXOHEK DOKUMENTI.

Ky material është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

- 1- **Përshkrimi i standardeve:** – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.
- 2- **Hyrje:** – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të kuptohet më lehtë.
- 3- **Tema:-** Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për secilën temë.
- 4- **Aneke:** – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë shpjeguese në ndihmë të lexuesve.

Përmbajtja e Kapitullit 3 është strukturuar në 6 pjesë kryesore:

- 1- **Përshkrimi i temës** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës.
- 2- **Diagramat UML** – Këtu jepet Përmbajtja e Katalogut të Tipologjive përkthyer sipas gjuhës UML.
- 3- **Katalogu i Tipologjive** – Këtu shpjegohet struktura e temës me të gjithë elementët e saj përbërës.
- 4- **Metadata** – Këtu jepen specifikimet teknike për metadata-t e temës përkatëse.
- 5- **Sistemi Koordinativ Reference** – Këtu përcaktohet referencë sistemi koordinativ që është miratuar sipas vendimit Nr. 669, datë 7/8/2013, i ndryshuar me vendim Nr. 322, datë 27.4.2016.
- 6- **Cilësia e të dhënave** – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementëve dhe matjes së tyre.

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe marrëdhëniet mes tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeopapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në ‘Katalogun e tipologjive’ (Feature Catalogue). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike,

por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit, Katalogu i tipologjive mund të jetë veçanërisht i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhënat e nevojshme për aplikacionet që ata përdorin.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit në tabelat e të dhënave në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të një shablloni, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të attributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shablloni, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kod listës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Tipi i tipologjisë	Tipi i elementit që mund të jetë i këtyre llojeve: «featureType» - një element që mund të jetë real në terren apo një dukuri abstrakte «dataType» - një element tabelor që shërben vetëm si tabelë attributesh për t'u lidhur me një element tjetër «enumeration» «codeList» - listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa <i>codeList</i> nënkupton “listë vlerash ose ndryshe kod listë”. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Numërtimet dhe kod listat”. «Imported» - të dhëna të specifikuar në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden “Të dhënat e importuara”
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë ose poligon. Abstrakt – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë 1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme. 1 - duhet të marrë detyruesisht 1 vlerë
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve “Rol shoqërimet” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.



Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve -- Përshkrimi -- Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
♦ Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: <i>Ligjor</i> -- Emri -- Emërtimi i vlerës -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve
♦ Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh: <i>Joligjor</i> -- Emri -- Emërtimi i vlerës -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve



2.1.1. KARAKTERISTIKAT E <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi <<voidable>> përdoret për të përshkruar ato përkatësi të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore, edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha përkatësitë e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera 'void'. Një vlerë void nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave gjeohapësinore që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës void duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur duke përdorur një nga vlerat e listuara në kod listën VleraArsyesSëPavlefshmërisë (VoidReasonValue).

Stereotipi <<voidable>> nuk jep informacion nëse karakteristika ekziston apo jo në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 1..*.

2.1.2. NUMËRTIMET DHE KOD LISTAT (ENUMERATION AND CODELIST)

Kod listat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kod listë, 'vlera të tjera' përcakton llojin e përmbajtjes së kod listës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

'jo' përfaqëson kod lista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë rregullore.

'të kufizuara' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

'të hapura' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

'po' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në rregullore.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kod lista me vlera *jo* të përmbajtura në rregullore, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që dhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.



2.1.3. PARAQITJA E ASPEKTIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin “FillimiICiklitJetësor” dhe “PërfundimiICiklitJetësor” për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi “FillimiICiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi “PërfundimiICiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin “PërfundimiICiklitJetësor” nuk shkaktojnë ndryshime në atributin “FillimiICiklitJetësor”.

❖ Shënim i rëndësishëm:

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. *FeatureType*, *DataType* etj, nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.2. DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të ligjit Nr. 72/2012, neni 16, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ASIG është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet europiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore për krijimin e NSDI në Shqipëri janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë këtë direktivë.
- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa attribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.3. FUSHA E VEPRIMIT

Të gjitha autoritetet publike, kompani private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen kësaj rregulloreje.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:




Figura 1



Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi – Është procesi gjatë të cilit mbledhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jocilësore në të dhënat e publikuara.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet më të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të paaksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose në legjislacione në fuqi.



3. TEMA

3.1. EMËRTIMET GJEOGRAFIKE

Emërtimet gjeografike përfshihen në Aneksin I të direktivës, që do të thotë se ato konsiderohen si të dhëna referencë, d.m.th. të dhëna që përbëjnë kornizën gjeohapësinore për njohjen e vendndodhjes gjeografike në përgjithësi, si dhe duke bërë lidhjen dhe / ose duke treguar informacione të tjera që u përkasin fushave specifike tematike, të tilla si: mjedisi, adresat, menaxhimi i sipërfaqes, shëndeti i njeriut dhe shumë të tjera.

Emërtimet gjeografike përdoren gjerësisht në komunikimin e përditshëm për t'iu referuar objekteve të ndryshme natyrore dhe atyre të bëra nga dora e njeriut në botën reale. Rrjedhimisht ato janë të ndërlidhura me temat e tjera në INSPIRE. Zakonisht njësive administrative, adresave, elementeve të hidrografisë (liqenet, lumenjtë etj.), elementeve të rrjeteve të transportit (aeropotet, urat etj.) dhe vendeve të mbrojtura u referohemi me emrin që kanë.

Emërtimet gjeografike përdoren së tepërmi kur kërkoni: informacione në shërbimet e web-it (përfshirë gjeoportalet), të navigoni, të referoni informacione tematike për një vendndodhje (gjeokodim), të shfaqni informacionin gjeografik në harta dhe ekrane, si dhe kur përpunoni grupe të dhënash gjeohapësinore, të cilat përbëjnë të dhëna historike. Përdorimi i saktë i emërtimeve gjeografikë është një aspekt parësor i komunikimit të përditshëm; si pasojë, statusi (zyrtar, historik), karakteristikat gjuhësore (gjuha, drejtshkrimi, transliterimi përfundimtar etj.) janë një interes kryesor për shumë përdorues, përfshirë agjencitë e shtypit, botuesit e hartave, autoritetet etj.

Specifikimi i të dhënave INSPIRE tek emërtimet gjeografikë është përgatitur duke ndjekur parimin pjesëmarrës të një procesi ndërtimi me konsensus. Grupi tematik i punës përgjegjës për zhvillimin e specifikimit të emërtimeve gjeografike u ngrit prej ekspertësh nga Belgjika, Finlanda, Gjermania, Norvegjia dhe Spanja. Prosesi i specifikimit u realizua në përputhje me metodologjinë e përpunuar për INSPIRE, duke respektuar kërkesat dhe rekomandimin e Modelit Përgjithshëm Konceptual të INSPIRE.

Në jetën e përditshme, të njëjtit vend mund t'i referohesh me disa emra. Në mënyrë që kjo qasje të pasqyrohet, elementi qendror i modelit të të dhënave të Emërtimeve gjeografikë të INSPIRE është objekti gjeohapësinor “Emërtimi i vendit”, i cili mund të mbartë një ose më shumë emra. Specifikimet e Emërtimeve gjeografike mund të përdoren për modelimin e emërtimeve në çdo temë tjetër të INSPIRE.

Çdo vend i emërtuar ka një identifikues unik INSPIRE. Më tej ai karakterizohet nga emërtimi(et) përfundimtar(e), përfaqësimi gjeometrik dhe, nëse është në dispozicion, lloji, lloji lokal, shkalla treguese e përdorimit dhe objekti gjeohapësinor i mundshëm me të cilin lidhet. E fundit ndihmon në ruajtjen e përputhjes mes të dhënave në nivele të ndryshme detajesh. Veç kësaj, duhet të jepet edhe informacioni i ciklit jetësor, nëse është në dispozicion.

Emërtimet gjeografike janë emra të vërtetë, që përdoren për entitete në botën reale. Të gjithë emërtimet që lidhen me të njëjtin entitet në botën reale duhet të ofrohen me drejtshkrimin e saktë. Nëse është në dispozicion, jepen karakteristika të mëtejshme për emrat, të tilla si: gjuha, burimi dhe statusi i emrit, shkrimi i përdorur dhe (sipas rastit) skema e transliterimit¹. Një atribut specifik përshkruan nëse emri

¹ Transliterim nënkupton konvertimin e një fjale nga një lloj alfabeti në një tjetër p.sh. alfabeti grek në atë latin (Ελληνες - Hellenes').



është një *endonim* ose *ekzonim*. Si pjesë e informacionit gjuhësor, shqiptimi i emërimit mund të jepet ose duke përdorur Alfabetin Fonetik Ndërkombëtar, ose duke lidhur URI21 të një skedari zëri.

Ndërveprueshmëria mbështetet gjithashtu nga një sistem i përbashkët referimi dhe nga dispozita për paraqitjen vizuale. Për të fundit jepen rregulla të thjeshta për një paraqitje të parazgjedhur.

Vlera kryesore e modelit INSPIRE të emërtimeve gjeografike është një strukturë e thjeshtë, por fleksibël, e cila lejon përdorimin e emërtimeve gjeografike si atribut i një objekti gjeohapësinor, i modeluar në temën “Emërtimet gjeografike” ose në çdo temë tjetër të INSPIRE. Mundësia e lidhjes së më shumë emrave me të njëjtat vende të emërtuara ofron mundësinë e integritit të gjuhëve të minoriteteve dhe të ekzonimeve, të cilat përbëjnë një kontribut të rëndësishëm për shumëgjuhësinë evropiane.

3.1.1. PËRSHKRIMI I TEMËS

Përkufizimi:

Emërtimi i zonave, i rajoneve, i lokaliteteve, i qyteteve, i periferive, i qyteteve ose i vendbanimeve apo i çdo karakteristike gjeografike ose topografike të interesit publik ose historik. [Direktiva 2007/2/EC]

Përshkrimi:

Ky specifikim të dhënash përshkruan konceptet e lidhura me emërtimet gjeografike, p.sh. emërtimi i saktë që përdoret për një subjekt natyral, të bërë nga dora e njeriut ose kulturor në botën reale. Specifikimi i të dhënave ndikohet nga situata shumëgjuhësore në Europë: një entitet gjeografik mund të ketë emra të ndryshëm në një ose disa gjuhë, po ashtu çdo emërtim mund të ketë grafi të ndryshme.

Për shkak të këtij konteksti shumëgjuhësor, ky specifikim përkufizohet në një objekt gjeohapësinor që është ‘*emërtimi i vendit*’, ndërsa ‘*emërtimi gjeografik*’ shikohet si informacion i lidhur me vendin e emërtuar. Megjithatë, produkti përqendrohet më shumë në përshkrimin e emërtimeve, se sa në përshkrimin e objekteve gjeohapësinore: në veçanti ai përshkruan karakteristikat e emrave, siç është gjuha dhe drejtshkrimi i tyre në shkrime të ndryshme.

Në disa raste emrat mund të përdoren si attribute të objekteve gjeohapësinore të modeluara në temat e tjera sipas direktivës INSPIRE. Megjithatë, shpesh, përkufizimi, klasifikimi, geometria dhe attribute të tjera të këtyre objekteve jo domosdoshmërisht korrespondojnë me ‘*emërtimin e vendit*’, respektivisht sipas përcaktimit nga ky specifikim të dhënash që fokusohet në aspektet e emrave. Për më tepër, entitetet gjeografike të emërtuara, të tilla si: ngritjet, ishujt ose formacionet e tokës bregdetare etj., janë modeluar si objekte gjeohapësinore në tema të tjera, ndërkohë që janë modeluar si vende të emërtuara në këtë specifikim.

Emërtimet gjeografike shërbejnë si mënyrë për të identifikuar vendndodhjet. Ato mund të përdoren së bashku me informacionin e duhur në entitetin e emërtuar, në produkte të ndryshme, si: harta, botime zyrtare apo shërbime përkatëse. Botimet zyrtare dhe shërbimet përkatëse i shoqërojnë emërtimet me tipologjinë përkatëse ose me vendndodhje përmes koordinatave. Ndër nevoja të tjera, ky specifikim të dhënash synon t’i përgjigjet nevojës për një botues zyrtar (shërbim) shumëgjuhësh paneuropian, i cili me shumë mundësi do të ngrihet si pjesë e INSPIRE.

Lloji i vetëm i tipologjisë në këtë temë është lloji ‘*Emërtimi i vendit*’, i cili përfaqëson çdo entitet të botës reale të referuar me një ose disa emra të përveçëm. Secili ‘*Emërtim i vendit*’ shoqërohet me një ose disa emërtime gjeografike, p.sh. me emra të përveçëm që aplikohen tek objekti gjeohapësinor, modeluar me llojin e të dhënave ‘*Emërtimi gjeografik*’. Emërtimet e ndryshme gjeografike të një objekti



të dhënë gjeohapësinor mund të jenë emrat në gjuhë të ndryshme ose në forma të ndryshme (p.sh. format e plotë dhe të shkurtra të emrave të shtetit dhe të njësisë administrative).

Çdo *‘Emërtim gjeografik’* mund të ketë një ose disa grafi, d.m.th. mënyra të veçanta të të shkruarit, në një ose disa shkrime, të tilla si: latin / romak, grek dhe cirilik, modeluar me llojin e të dhënave *‘Grafia e emrit’*.

Për shembull:

- Qyteti i Athinës mund të jetë modeluar në skemë si *‘Emërtimi i vendit’*.
- *Endonimi* “Athína” (greqisht) dhe *ekzonimi* “Athens” (anglisht) janë dy *‘Emërtime gjeografike’* të këtij *‘Emërtimi vendi’* unik.
- “Aθnva” (shkrim grek) dhe romanizimi i tij standard “Athína” (shkrim latin) janë dy *‘Grafia të emrit’* të ndryshme për të njëjtin *‘Emërtim gjeografik’* “Athína”.



3.1.2. DIAGRAMET UML

3.1.2.1. SKEMA E APLIKIMIT TË 'EMËRTIMET GJEOGRAFIKE'




Figure 1: Emërtimet gjeografike - Të përgjithshme

3.1.2.2. TIPOLOGJIA E TEMËS: EMËRTIMET GJEORAFIKE - DIAGRAM



Figure 2: Tipologjia e temës: Emërtimet gjeografike

3.1.2.3. DIAGRAMI I VARËSIVE




Figure 3: Varësitë

3.1.2.4. NUMËRTIMET DHE KOD LISTAT




Figure 4: Numërtimet dhe Kod listat

3.1.2.5. TIPAT E TË DHËNAVE - DATA TYPE




Figure 5: Tipat e të dhënave - Data Type



3.1.3. KATALOGU I TIPOLOGJISË – FEATURE CATALOGUE

3.1.3.1. EMËRTIMET GJEOGRAFIKE

-- Emri --

Emërtimet gjeografike

-- Përkufizimi --

Emërtimi i duhur që i përket entitetit real në botë

Tipi i elementit - Data type

ATTRIBUTE
♦ Grafia: GrafiaEEmrit Shumëllojshmëria: [1..*] -- Emri -- Grafia e emrit -- Përkufizimi -- Tërësia e shenjave të shkrimit që përdoren në një a në disa gjuhë; tërësia e llojeve të shkronjave të dorës e të shtypit që përdoren në një gjuhë. -- Përshkrimi -- Shënim 1 - Duhet të përdoren grafi të ndryshme vetëm për emrat e paraqitur në shkrime të ndryshme. Shënim 2 - Një emërtim gjeografik i veçantë duhet të ketë vetëm një grafi në një shkrim të dhënë; nëse në të njëjtin shkrim ka grafi të ndryshme, kjo duhet të kryhet përmes krijimit të emërtimeve të ndryshme gjeografike që lidhen me të njëjtin vend të emërtuar. [I detyrueshëm: PO]
♦ GjiniaGramatikore: VleratEGjinisëGramatikore Shumëllojshmëria: [0..1] -- Emri -- Gjinia gramatikore -- Përkufizimi -- Kategori gramatikore e emrit që reflektohet dhe në formën e fjalëve që lidhen me të. -- Përshkrimi -- Shënim 1 - Atributi ka shumëllojshmëri (mundësi popullimi) [0..1] dhe është “voidable”, që do të thotë se: - Në rast se koncepti i gjinisë gramatikore nuk ka kuptim për një emërtim të dhënë (d.m.th. atributi nuk është i aplikueshëm), atributi nuk duhet të plotësohet. - Në rast se koncepti i gjinisë gramatikore ka disa kuptime për emrin, por është i panjohur, atributi duhet të plotësohet, por duhet të jetë “voidable = pa vlerë”. [I detyrueshëm: PO]



ATTRIBUTE

🔹 Gjuha: Text (CharacterString)

-- Emri --

Gjuha

-- Përkufizimi --

Gjuha e emrit e dhënë si një kod me tre shkronja, në përputhje me ISO 639-3 ose ISO 639-5.

-- Përshkrimi --

Shënim 1 - Më saktë ky përkufizim i referohet gjuhës së përdorur nga komuniteti që përdor emrin.

Shënim 2 - Kodi "mul" për "multilingual" nuk duhet përdorur. Megjithatë mund të përdoret në raste të rralla si emrat zyrtarë të përbërë nga dy emra në gjuhë të ndryshme. Për shembull, "Vitoria-Gasteiz" është një emër zyrtar shumëgjuhësh në Spanjë.

Shënim 3 - Edhe nëse ky atribut është "voidable" për arsye pragmatike, ka një rëndësi parësore në disa raste përdorimi në kontekstin shumëgjuhësh të Europës.

[I detyrueshëm: PO]

🔹 NumriGramatikor: VleraENumritGramatikor
Shumëllojshmëria: [0..1],

-- Emri --

Numri gramatikor

-- Përkufizimi --

Kategoria gramatikore e emrave që shpreh dallime sasiore.

-- Përshkrimi --

Shënim 1 - Atributi ka shumëllojshmëri (mundësi populimi) [0..1] dhe është "voidable", që do të thotë se:

- Në rast se koncepti i numrit gramatikor nuk ka kuptim për një emërtim të dhënë (d.m.th. atributi nuk është i aplikueshëm), atributi nuk duhet të plotësohet.

- Në rast se koncepti i numrit gramatikor ka disa kuptime për emrin, por është i panjohur, atributi duhet të plotësohet, por të jetë "voidable = pa vlerë".

[I detyrueshëm: PO]

🔹 OrigjinaEEmrit: Text (CharacterString)

-- Emri --

Origjina e emrit

-- Përkufizimi --

Burimi i të dhënave origjinale nga është marrë emërtimi gjeografik dhe është integruar në grupin e të dhënave që e ofron / publikon atë. Për disa objekte gjeohapësinore të emërtuara mund t'i referohemi sërish grupit të të dhënave të publikuara, nëse nuk ka informacion tjetër në dispozicion.

[I detyrueshëm: JO]

🔹 Prejardhja: VleraEPrejardhjes



ATTRIBUTE
-- Emri -- Prejardhja -- Përkufizimi -- Informacioni që mundëson njohjen e emërimit që përdoret / është përdorur në zonën ku objekti gjeohapësinor ndodhet në çastin kur emri është / ishte në përdorim . [I detyrueshëm: JO]
◆ Shqiptimi: ShqiptimiIEmrit -- Emri -- Shqiptimi -- Përkufizimi -- Shqiptimi i duhur, i saktë ose standard (standard brenda komunitetit përkatës gjuhësor) i emërimit gjeografik. [I detyrueshëm: JO]
◆ StatusiIEmrit: VleraEStatusiTëEmrit -- Emri -- Statusi i emrit -- Përkufizimi -- Informacioni cilësor që mundëson dallimin e vlerësimit që duhet t'i jepet emërimit në përputhje me standardizimin e tij. -- Përshkrimi-- Skema e aplikimit të Emërtimeve gjeografike nuk sjell një parapëlqim të dukshëm mes emrave të ndryshëm (p.sh. endonimet zyrtare) të një entiteti specifik në botën reale. Informacioni i nevojshëm për një parapëlqim (p.sh. statusi gjuhësor i zonës administrative ose gjeografike në fjalë) për një çështje të caktuar duhet të përftohet nga të dhëna të tjera ose nga burime informacioni. Për shembull, statusi i gjuhës së emrit mund të mësohet përmes kërkesave për gjeometrinë e vendeve të emërtuara përkundrejt gjeometrisë së njësive administrative të regjistruara nga një burim i caktuar me informacionin e statuseve të gjuhës. [I detyrueshëm: PO]

3.1.3.2. EMËRTIMI I VENDIT

-- Emri --
Emërtimi i vendit

-- Përkufizim --
Çdo entitet (subjekt) real botëror, të cilit i referohen një ose më shumë emra të përveçëm.

Tipi i elementit - Feature type



ATTRIBUTE

◆ Emërtimi: EmërtimetGjeografike
Shumëllojshmëria: [1..*],

-- Emri --

Emërtimi

-- Përkufizimi --

Emërtimi i vendit

[I detyrueshëm: PO]

◆ Fillimi i Ciklit Jetësor: DataOra

-- Emri --

Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është krijuar ose ndryshuar në të dhënat gjeohapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

◆ Gjeometria: NëVarësi

-- Emri --

Gjeometria

-- Përkufizimi --

Gjeometria e lidhur me vendin e emërtuar. Ky specifikim teknik nuk përcakton (detyron) llojin e gjeometrisë së elementeve.

-- Përshkrimi --

Shënim 1 - Në përgjithësi, gjeometria më e zakonshme për Emërtimin e vendit është një pikë referuese (gjeometria pikë - GM_Point), një gjurmë (gjeometria vijë - GM_Curve) apo një kuadrat (gjeometria poligon - GM_Surface).

Shënim 2 - Nëse gjeometria përshkruan një gjurmë gjeohapësinore të një vendi të emërtuar, atëherë një pikë reference apo një kuadrat mund të gjenerohet automatikisht nga ajo.

Shënim 3 - Për të eliminuar ndonjë keqkuptim, theksohet që gjeometria e papërcaktuar (null) nuk është e lejuar.

Shënim 4 - Gjeometria 3D nuk është e nevojshme për Emërtimet gjeografike, por modeli e mundëson nëse diçka e tillë sigurohet nga prodhuesi.

[I detyrueshëm: PO]

◆ InspireId: Identifikues

-- Emri --

Inspire Id

-- Përkufizimi --

Identifikues i jashtëm i objektit gjeohapësinor.

-- Përshkrimi --

Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga organi përgjegjës, që mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit gjeohapësinor. Identifikuesi është identifikues i objektit gjeohapësinor, jo identifikues i dukurisë në botë.



ATTRIBUTE
[I detyrueshëm: PO] Lloji: VleraELlojitTëEmërtimitTëVendit Shumëllojshmëria: [1..*] -- Emri -- Lloji -- Përkufizimi -- Karakterizimi i llojit të entitetit i projektuar nga emërtimet gjeografike. -- Përshkrimi -- Shënim 1 - Ky atribut duhet të jetë në përputhje me atributin 'ObjektiHapësinorILidhur'. Më saktë, nëse atributi 'ObjektiHapësinorILidhur' është i plotësuar, atributi 'Lloji' duhet plotësuar dhe vlera(t) e saj duhet të jetë në përputhje me motivin(et) e të dhënave gjeohapësinore të objektit(eve) përkatës/e. Shënim 2 - Edhe nëse ky atribut mund të ketë disa ndryshime nga atributi 'ObjektiHapësinorILidhur', duhet plotësuar në mënyrë që të lejojë përdorimin e emërtimeve gjeografikë më vete, pa hyrë në grupet e tjera të të dhënave të INSPIRE, e cila mund të jetë e nevojshme në shumicën e rasteve. [I detyrueshëm: PO]
LlojiLokal: TekstLokal Shumëllojshmëria: [1..*] -- Emri -- Lloji lokal -- Përkufizimi -- Karakterizimi i llojit të entitetit të projektuar nga emërtimi gjeografik, siç përcaktohet nga ofruesi i të dhënave, dhënë të paktën në njërin nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian. [I detyrueshëm: JO]
PërfundimiICiklitJetësor: DataOra Shumëllojshmëria: [0..1] -- Emri -- Përfundimi i ciklit jetësor -- Përkufizimi -- Data në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është përfunduar. [I detyrueshëm: JO]
ObjektiHapësinorILidhur: Identifikues Shumëllojshmëria: [0..*] -- Emri -- Objekti gjeohapësinor i lidhur -- Përkufizimi --



ATTRIBUTE

Identifikuesi i objektit gjeohapësinor që përfaqëson të njëjtin entitet, por që shfaqet në temat të tjera të INSPIRE.

-- Përshkrimi --

Nëse nuk jepet asnjë identifikues me tipologjitë e temave të tjera të INSPIRE, këto tipologji nuk mund të referohen nga Emërtimi i Vendit.

[I detyrueshëm: PO]

◆ Shkalla Maksimale: Rezolucioni i Shikimit
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Shkalla maksimale e rezolucionit në shërbim të shikimit

-- Përkufizimi --

Rezolucioni i shprehur si e anasjella e një shkallë treguese ose e një distancë tokësore nën të cilin vendi i emërtuar dhe emërtimi që e shoqëron nuk duhet të shfaqet më në shërbimin e shikimit.

-- Përshkrimi --

Shembull 1 - Emrat e zonave të mëdha, si vargjet malore, mund të shfaqen në të gjitha shkallët e shikimit më të mëdha se 1/100,000. Në këtë rast, vlera e cilësisë është 100,000.

Shembull 2 - Emrat e fshatrave të vegjël mund të shfaqen në çdo shkallë të madhe. Në këtë rast, kjo cilësi nuk është e plotësuar.

[I detyrueshëm: PO]

◆ Shkalla Minimalet: Rezolucioni i Shikimit
Shumëllojshmëria: [0..1],

-- Emri --

Shkalla minimale në shërbim të shikimit.

-- Përkufizimi --

Rezolucioni i shprehur si e anasjella e një shkallë treguese ose e një distance tokësore, mbi të cilin vendi i emërtuar dhe emërtimi që e shoqëron nuk duhet të shfaqet më në shërbimin e shikimit.

-- Përshkrimi --

Shënim 1 - Ky informacion mund të përdoret për të përcaktuar nëse emërtimet e vendit duhet të shfaqet në një shkallë të caktuar të ekranit, vetëm në kontekstin e shërbimeve bazë të shikimit që synojnë të tregojnë përmbajtjen e grupit të të dhënave që përmban emrat. Edhe në qoftë se ky informacion është i vlefshëm për një hartë në përgjithësi, ai është vetëm i përafërt; shërbimet hartografike që synojnë të prodhojnë harta të cilësisë së lartë duhet të mbështeten patjetër në kritere dhe teknika të tjera gjatë përzgjedhjes së emërtimeve për hartën.

Shënim 2 - Edhe në qoftë se ky atribut është "Voidable", për arsye praktike të lidhura me disponibilitetin e saj në burimet e të dhënave, ky informacion mund të jetë i pari për nga rëndësia për shërbimin e shikimit. Ka gjasa të mëdha që shërbimet e shikimit të menaxhojnë në mënyrë joefikase emërtimet që e kanë bosh këtë atribut.

Shembull - Shembujt e mëposhtëm përdorin shkallën e rezolucionit për të shprehur vlerën e atributit.

- Emrat e qyteteve të rëndësishme në Europë mund të shfaqen në të gjitha shkallët më të mëdha se 1 / 5,000,000. Në këtë rast, vlera e atributit është 5,000,000.

- Emrat e fshatrave të vegjël mund të shfaqen vetëm në shkallët më të mëdha se 1 / 25,000. Në këtë rast, vlera e atributit është 25,000.

- Emrat e vendeve mund të shfaqen në çdo shkallë të vogël. Në këtë rast, ky atribut nuk është i mbushur.



ATTRIBUTE

Shënim 3. Nëse grupet e të dhënave përmbajnë nivele të ndryshme të detajimit për shkallën e shfaqjes, vlerat e attributeve në “ShkallënMinimale dhe në ShkallënMaksimale” nuk duhet të mbivendosen, në mënyrë që të shmangët shfaqja disa herë e të njëjtëve emra.

Shënim 4. Gjeometria e EmërimitTëVendit duhet të ketë një nivel të detajeve (d.m.th. rezolucion, saktësi etj.) në përputhje të përafërt me shkallët që lidhen me shërbimin e shikimit.

[I detyrueshëm: PO]

ROL SHOQËRIMI

Burimi: FillimiICiklitJetësor (Class) EmriAdresësSëBashkisë «featureType»

-- Përkufizim --

Përfaqëson, që komponenti i adresës “Emri adresës së bashkisë” është bazuar në elementin “Emërimit gjeografik” (nga skema e Emërimeve gjeografik).

Burimi: FillimiICiklitJetësor (Class)
EmriAdresësSëBashkisë «featureType»

-- Përkufizim --

Përfaqëson, që komponenti i adresës “Emri adresës së bashkisë” është bazuar në elementin “Emërimit gjeografik” (nga skema e Emërimeve gjeografik).

Objekti: «voidable» EmërimitVendit (Class)
EmërimitVendit «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..1]

--Përkufizim --

Emërimit i vendit që ky pozicionim përfaqëson.

-- Përshkrim --

Në mënyrë që të popullohet kjo lidhje, është e rëndësishme që zonë e përfaqësuar nga Emërimit i vendit, është në pozicionimin e saktë që adresa mbulon. Nëse nuk përputhet atëherë lidhja do të kemi mospërputhje.

Shembull

Emërimit gjeografik “Huskvarna”, i cili përfaqëson një pjesë të bashkinë “Jönköping” në Suedi, është burimi i zonës me emërimit adrese, “Huskvarna”.

3.1.3.3. GRAFIA E EMRIT

-- Emri --

Grafia e emrit

-- Përkufizimi --

Mënyra e duhur e shkrimit të emrit

-- Përshkrimi --

Shënim - Drejtshkrimi i duhur do të thotë: shkrimi i një emri me shkronjat e sakta, sipas rregullave për shkronjën e madhe dhe me shenjat diakritike sipas një standardi të pranuar.

*Tipi i elementit - Data type*

ATTRIBUTE
◆ SkemaEKonvertimit: Text (CharacterString) Shumëllojshmëria: [0..1] -- Emri -- Skema e konvertimit -- Përkufizimi -- Metoda e përdorur për konvertimin e emrave mes shkrimeve të ndryshme. -- Përshkrimi -- Shënim 1- Ky atribut duhet të plotësohet për çdo drejtshkrim të transliteruar. Nëse skema e transliterimit të përdorur është regjistruar në listat e kodit të mirëmbajtura nga ISO ose UN, atëherë duhet të parapëlqehen këto kode. [I detyrueshëm: JO]
◆ SkriptiAlfabetik: Text (CharacterString) -- Emri -- Skripti alfabetik -- Përkufizimi -- Grup simbolesh grafike (për shembull alfabeti) që përdoret në shkrimin e emrit dhe shprehet me kode me katër shkronja të përcaktuara në ISO 15924, sipas rastit. -- Përshkrimi -- Shkrimi cirilik, grek, romak / latin. Shënim 1 - Kodet me katër shkronja për shkrimin latin (romak), cirilik dhe grek janë përkatësisht "Latn", "Cyril" dhe "Grek". Shënim 2 - Në raste të rralla mund të përdoren kode të tjera (për shkrime të tjera ndryshe nga ai latin, grek dhe cirilik). Megjithatë, kjo duhet të përdoret kryesisht për emra historikë në shkrime historike. Shënim 3 - Ky atribut është i një rëndësie parësore në kontekstin e shumëllojshmërisë së shkrimeve (multi-scriptual) të Europës. [I detyrueshëm: PO]
◆ Teksti: Text (CharacterString) -- Emri -- Teksti -- Përkufizimi -- Mënyra si është shkruar emri. [I detyrueshëm: PO]



3.1.3.4. SHQIPTIMI I EMRIT

-- Emri --

Shqiptimi i emrit

-- Përkufizimi --

Shqiptimi i duhur, i saktë ose standard (standard brenda komunitetit përkatës gjuhësor) i emrit.

Tipi i elementit - Data type

ATTRIBUTE
◆ LinkuIShqiptimit: URI Shumëllojshmëria: [0..1], -- Emri -- Link-u i shqiptimit -- Përkufizimi -- Shqiptimi i duhur, i saktë ose standard (standard brenda komunitetit përkatës gjuhësor) i një emri, i paraqitur me një link me skedar zëri. [I detyrueshëm: JO]
◆ ShqiptimiAFN: Text (CharacterString) Shumëllojshmëria: [0..1], -- Emri -- Shqiptimi sipas AFN -- Përkufizimi -- Shqiptimi i duhur, i saktë ose standard (standard brenda komunitetit përkatës gjuhësor) i një emri, shprehur sipas Alfabetit Fonetik Ndërkombëtar - AFN (International Phonetic Alphabet). [I detyrueshëm: JO]

3.1.3.5. VLERA E LLOJIT TË EMËRTIMIT TË VENDIT

-- Emri --

Vlera e llojit të emërtimit të vendit

-- Përkufizimi --

Lloji i emërtimit të vendit

Tipi i elementit - Kod listë



ATTRIBUTE

◆ FormaGjeomorfologjike:

-- Përkufizimi --

Forma gjeomorfologjike e terrenit.

Shembuj

- Relievat e ngritura, si: vargmalet, malet, faqet dhe majat e maleve, kodra etj.
- Relievat e rrafshëta, si: rrafshina, lugina, gryka etj.
- Ishuj, ishuj shkëmborë, arkipelagë;
- Formacionet e tokës bregdetare, si gadishuj, kepa, delta, plazhe shkëmb etj.;
- Format tokësore të tjera, të tilla si shpella, gropa etj.

◆ Hidrografia:

-- Emri --

Hidrografia

-- Përkufizimi --

Elementet hidrografike, duke përfshirë zonat detare dhe të gjithë trupat e tjerë detarë që lidhen me të, përfshirë basenat lumore dhe nënbasenat.

-- Përshkrimi --

Për përdorimin e Emërtimeve gjeografike që përfshijnë emërtimin e vendit në dete dhe oqeanë.

Shembuj

- Zonat detare dhe pjesët e saj, si: det, ngushticë, gji, kanal etj.
- Zonat e ujit në brendësi të tilla si liqen, rezervuar, pellg, ngushtica liqenesh etj.;
- Rrjedhjet ujore, si: lumenj, përrenj, ujëvara etj.;
- Elemente të tjera hidrografike, si akullnaja, fusha të mbuluara me borë, burime etj.

◆ MbulesaETokës:

-- Përkufizimi --

Mbulesa fizike dhe biologjike e sipërfaqes së tokës, përfshirë edhe sipërfaqet artificiale, sipërfaqet agrikulturore, pyjet, zonat gjysmënatyrore, zonat e lagura, trupat ujorë etj.

Shembuj

- Pyjet
- Zonat e vegjetacionit të ulët, si shkurre.
- Zonat e lagura, si: kënetë, moçal etj.

◆ Ndërtesat:

-- Përkufizimi --

Vendndodhja gjeografike e ndërtesës.



ATTRIBUTE

--Shembuj--

- Objektet publike, si: teatro, muze, librari etj.
- Objektet industriale.
- Objektet fetare, si: kisha, xhami, teqe, sinagoga etj.
- Ndërtesat argëtuese, si: stadione etj.
- Sitet historike dhe antike.
- Monumentet e kulturës.

KufijtëENjësieAdministrative:

-- Përkufizimi --

Njësitë administrative, zona të ndara ku shtetet anëtare kanë dhe / ose ushtrojnë të drejtat juridike për qeverisjen lokale, rajonale dhe kombëtare, e ndarë nga kufijtë.

Shembuj

- Shteti
- Njësitë administrative brenda një vendi, si: shteti, qarku, bashkia apo njësia administrative.

Të tjera:

-- Përkufizimi --

Objekt gjeohapësinor që nuk përfshihet në listën e mësipërme të kodlistës.

Rrjeti i transportit :

-- Përkufizimi--

Rrugë, hekurudhë, rrjeti i transportit ujor dhe ajror dhe infrastruktura që lidhet me to. Përfshin lidhjet ndërmjet rrjeteve të ndryshme.

Shembull:

- Struktura e transportit ajror dhe pajisjet si: aeroportet, heliportet etj.
- Struktura e transportit ujor dhe pajisjet si: linjat e trageti, porte, mole etj.
- Struktura e transportit hekurudhor dhe pajisjet si: stacionet e trenit, urat dhe tunelet hekurudhore etj.
- Struktura e transportit rrugor dhe pajisjet si: stacionet e autobuzave, autostradat, rruget, urat dhe tunelet rrugore.

ZonatEMbrojtura:

-- Përkufizimi --

Zonë e caktuar ose e menaxhuar brenda një kuadri të ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shembull

Park kombëtar, rezervë natyrore.

ZonatEPopulluara :

-- Përkufizimi--



ATTRIBUTE
Një zonë e populluar me njerëz.
Shembull
• Qytete, qyteza, rrethina etj. • Fshatra te vegjel, shtëpi të izoluar.

3.1.3.6. VLERE E NUMRIT GRAMATIKOR

-- Emri--

Vlera e numrit gramatikor

-- Përkufizimi --

Numri gramatikor i Emërimit gjeografik.

Tipi i elementit – Kod listë

ATTRIBUTE
◆ Njëjës: -- Emri -- Njëjës -- Përkufizimi -- Numri njëjës i Emërimit gjeografik.
◆ Shumës: -- Emri -- Shumës -- Përkufizimi -- Numri shumës i Emërimit gjeografik.

3.1.3.7. VLERE E PREJARDHJES

-- Emri--

Vlera e prejardhjes

-- Përkufizimi --

Prejardhja e Emërimit gjeografik.

Tipi i elementit – Kod listë

ATTRIBUTE
◆ Ekzonime:



ATTRIBUTE
-- Emri -- Ekzonim -- Përkufizimi -- Emri i përdorur në një gjuhë specifike për një tipologji gjeografike që ndodhet jashtë zonës ku gjuha flitet gjerësisht dhe ndryshon në formë nga endonimi(et) përkatës në zonën ku gjendet kjo tipologji gjeografike.
◆ Endonime: -- Emri -- Endonim -- Përkufizimi -- Emri i përdorur për një tipologji gjeografike, në një gjuhë të mirëpërcaktuar që ndeshet në të njëjtën zonë ku gjendet kjo tipologji.

3.1.3.8. VLERË E STATUSIT TË EMRIT

-- **Emri** --

Vlera e statusit të emrit

-- **Përkufizimi** --

Statusi i Emërimit gjeografik është informacioni që i vendoset atij për ta dalluar çfarë cilësie duhet t'i vendoset emërimit në përputhje me standardizimin dhe/ose aktualitetin e tij.

-- **Përshkrimi** --

Shënim - Përkufizimi i saktë i vlerës 'Zyrtar', 'I standardizuar', 'Historik' dhe 'Të tjerë' mund të jepet vetëm nga shtetet anëtare në përputhje me ligjet dhe praktikën e tyre.

Tipi i elementit – Kod listë

ATTRIBUTE
◆ Historik: -- Emri -- Historik -- Përkufizimi -- Emërtimi historik që nuk përdoret aktualisht.
◆ I standardizuar: -- Emri -- I standartizuar



ATTRIBUTE

-- Përkufizimi --

Emri në përdorim aktual dhe i pranuar apo i rekomanduar nga një trup me funksion këshillues dhe / ose me të drejtë në marrjen e vendimeve në çështjet e toponimeve.

💠 Të tjerë:

-- Emri --

Të tjerë

-- Përkufizimi --

Emërtim aktual sipas banorëve të zonës, që nuk është as zyrtar, as i standardizuar.

💠 Zyrtar:

-- Emri --

Zyrtar

-- Përkufizimi --

Emërtimi aktual dhe zyrtar i përcaktuar dhe i miratuar nga legjislacioni.

3.1.3.9. VLERA E GJINISË GRAMATIKORE

-- Emri--

Vlera e gjinisë gramatikore

-- Përkufizimi --

Gjinia gramatikore e Emërimit gjeografik.

Tipi i elementit – Kod listë

ATTRIBUTE

💠 Mashkullore:

-- Emri --

Mashkullore

-- Përkufizimi --

Gjinia mashkullore e Emërimit gjeografik.

💠 Femërore:

-- Emri --

Femërore

-- Përkufizimi --



ATTRIBUTE

Gjinia femërore e Emërimit gjeografik.

◆ Asnjanëse:

-- Emri --

Asnjanëse

-- Përkufizimi --

Gjinia asnjanëse e Emërimit gjeografik.



3.1.4. METADATA

Përshtatja e elementeve të metadatës përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 23.12.2015 “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”.

3.1.5. SISTEMI REFERENCË, NJESITË E MATJES DHE RRJETAT GJEOGRAFIKE.

3.1.5.1. SISTEMET STANDARDE TË REFERIMIT, NJESITË E MATJEVE DHE RRJETET

Sistemet e referencës, njësitë e matjeve dhe sistemet e rrjeteve gjeografike të përfshira në këtë nën-seksion janë standardet që do të përdoren për të gjitha grupet e të dhënave INSPIRE, përveç kur ka përjashtime specifike të temës dhe/ose kërkesa të tjera të përcaktuara në seksionin 6.2.

A. Korniza referuese gjeodezike e Shqipërisë

Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare që do të përdoret në Republikën e Shqipërisë do të quhet:

“Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare” ose shkurt (KRGJSH – kodi EPSG: 6870²). KRGJSH do të përcaktohet duke u mbështetur në Kornizën Referuese Gjeodezike Europiane. KRGJSH do të përdoret në të gjitha aplikacionet që lidhen me përdorimin e koordinatave në territorin e vendit. Lidhja midis KRGJSH dhe sistemeve të tjera të përdorura në vendin tonë do të bëhet duke përdorur parametrat e transformimit të llogaritura për çdo rast.

KRGJSH përfshin:

- a) parametrat gjeodezikë bazë të përcaktuar në Sistemin Referues Gjeodezik 1980 (GRS-80) si më poshtë:
 - Rrezja e ekuatorit të tokës: $a = 6\,378\,137\text{m}$;
 - Konstantja gravitacionale gjeocentrike e tokës duke përfshirë edhe atmosferën: $GM = 3\,986\,005 \times 10^{-8} \text{ m}^3\text{s}^{-2}$;
 - Faktori dinamik i figurës së tokës pa përfshirë baticën e qëndrueshme: $J_2 = 108\,263 \times 10^{-8}$;
 - Këtij faktori i korrespondon shtypja në pole: $1/f = 298.257222100882711$;
 - Shpejtësia këndore e rrotullimit të tokës: $\omega = 7\,292\,115.0 \times 10^{-11} \text{ rad.sek}^{-1}$
- b) sistemin koordinativ gjeodezik ETRS 89;
- c) sistemin e lartësive që realizohet nëpërmjet reperave të rrjetit shtetëror të nivelimit të përfshirë në Rrjetin Unik European të Nivelacionit (UELN) dhe të përcaktuara në Sistemin Referues Vertikal European (EVRs) me ndihmën e të dhënave për forcën e rëndesës të unifikuara në sistemin International Gravity Standardization Network 1971 (IGSN 1971).
- d) sistemin e koordinatave në plan, i cili mundësohet nga dy projeksione hartografike:
 - Projeksioni Tërthor Zonal i Merkatorit (TMzn) për harta në shkallë më të madhe se 1:500.000 me parametrat e mëposhtme:
 - Elipsoidi referencë: GRS80

² Shiko Aneks 4.3



- Meridiani fillestar: Grinuiç
- Meridiani qendror (MQ): 20°
- Shkalla e shformimit në meridianin qendror (k_0): 1
- Fallco e lindjes: 500 000 m
- Fallco e veriut: 0 m

- Projektioni Konik Konform i Lambertit (LCC) për harta në shkallë 1:500 000 dhe më të vogla.

B. Sistemet koordinative referencë sipas INSPIRE

I. Datumi

Datumi për sistemet koordinative referencë dy-dimensionale dhe tre-dimensionale

Për sistemet koordinative referencë dy-dimensionale dhe tre-dimensionale dhe komponentja horizontale e sistemeve koordinative referencë të kombinuara të përdorura për të bërë të disponueshme grupin e të dhënave gjeohapësinore, si datum do të jetë datumi i Sistemit Referencë Tokësor Europian 1989 (ETRS89) në zona brenda kufijve gjeografik të tij, ose datumi i Sistemit Referencë Tokësor Ndërkombëtar (ITRS) ose sisteme koordinative referencë gjeodezike të tjera të përputhura me ITRS, në zona që ndodhen jashtë kufijve gjeografik të ETRS89. Të përputhura me ITRS do të thotë që përkufizimi i sistemit bazohet në përkufizimin e ITRS dhe ka një marrëdhënie të mirë-dokumentuar mes dy sistemeve, sipas EN ISO 19111.

II. Sistemet koordinative referencë

Sistemet koordinative referencë

Grupet e të dhënave gjeohapësinore do të bëhen të disponueshme duke përdorur të paktën një prej sistemeve koordinative referencë të caktuara në seksionet 1.3.1, 1.3.2 dhe 1.3.3, përveç kur qëndron njëri prej kushteve të caktuara në seksionin 1.3.4.

1.3.1 Sistemet koordinative referencë tre-dimensionale

- Koordinatat karteziante tre-dimensionale bazohen në një datum të caktuar në seksionin 1.2 dhe përdorin parametrat e elipsoidit GRS80 (Sistemi Referencë Gjeodezik 1980).
- Koordinatat gjeodezike tre-dimensionale (gjerësia, gjatësia dhe lartësia elipsoidike) bazohen në një datum të caktuar në seksionin 1.2 dhe përdorin parametrat e elipsoidit GRS80.

1.3.2 Sistemet koordinative referencë dy-dimensionale

- Koordinatat gjeodezike dy-dimensionale (gjerësia dhe gjatësia) bazohen në një datum të caktuar në seksionin 1.2 dhe përdorin parametrat e elipsoidit GRS80.
- Koordinatat në plan përdorin sistemin koordinativ referencë ETRS89 me projektion LAEA (Lambert Azimuthal Equal Area) për analiza gjeohapësinore dhe raportime, ku duhet të pasqyrohen sipërfaqet e vërteta.
- Koordinatat në plan përdorin sistemin koordinativ referencë ETRS89 me projektion LCC (Lambert Conformal Conic) për hartografime konforme në territorin e Europës në shkallë të barabarta ose më të vogla se 1:500 000.
- Koordinatat në plan përdorin sistemin koordinativ referencë ETRS89 me projektion TM (Transverse Mercator) për hartografime konforme në territorin e Europës në shkallë të barabarta ose më të mëdha se 1:500 000.

1.3.3 Sistemet koordinative referencë të kombinuara



1. Për komponenten horizontale të sistemit koordinativ referencë të kombinuar, një prej sistemeve koordinative referencë të caktuara në seksionin 1.3.2 do të përdoret.
2. Për komponenten vertikale, do të përdoret një prej sistemeve koordinative referencë të mëposhtme:
 - Për komponenten vertikale në sipërfaqen tokësore, do të përdoret Sistemi Referencë Vertikal Europian (EVRS) për të shprehur lartësitë e lidhura me gravitetin brenda kufijve gjeografik të këtij sistemi. Në zona të cilat ndodhen jashtë kufijve gjeografik të EVRS, do të përdoren sisteme referencë vertikale të tjera të lidhura me fushën e gravitetit Tokësor për të shprehur lartësitë e lidhura me gravitetin.
 - Për komponenten vertikale në atmosferën e lirë, presioni barometrik i konvertuar në lartësi duke përdorur ISO 2533:1975 Atmosferën Standarde Ndërkombëtare, ose do të përdoren sisteme referencë të tjera lineare ose parametrike. Aty ku janë përdorur sisteme referencë parametrike të tjera, ato do të përshkruhen në një referencë të kuptueshme duke përdorur EN ISO 19111-2:2012.
 - Për komponenten vertikale në zonat detare ku ka një rang të ndjeshëm batice (ujëra baticor), si sipërfaqe referencë do të përdoret Batika më e ulët Astronomike (LAT).
 - Për komponenten vertikale në zonat detare ku nuk ka një rang të ndjeshëm batice, në oqeanet e hapura dhe efektivisht në ujëra me të thella se 200 metra, si sipërfaqe referencë do të përdoret niveli mesatar i detit (MSL) ose një nivel referencë i mirë-përcaktuar i afërt me MSL.

1.3.3 Sistemet koordinative referencë të tjera

Si përjashtime, ku mund të përdoren sisteme referencë të tjera nga ato të listuara në 1.3.1, 1.3.2 ose 1.3.3, janë:

1. Sisteme koordinative referencë të tjera mund të caktohen për temat e të dhënave gjeohapësinore specifike në këtë Aneks.
2. Për zonat (regjionet) që ndodhen jashtë kontinentit të Europës, Shtetet Anëtare (MS) mund të përcaktojnë sisteme koordinative referencë të përshtatshme.

Kodet gjeodezike dhe parametrat e nevojshëm për përshkrimin e këtyre sistemeve koordinative referencë dhe të cilat lejojnë veprimet e konvertimit dhe transformimit duhet të dokumentohen dhe duhet të krijohet një identifikues, sipas EN ISO 19111 dhe ISO 19127.

III. Paraqitja

Sistemet koordinative referencë të përdorura në shërbimin e shikimit të rrjetit

Për shfaqjen e grupeve të të dhënave gjeohapësinore nëpërmjet shërbimit të shikimit të rrjetit siç specifikohet në rregulloren nr. 976/2009, së paku sistemet koordinative referencë për koordinatat gjeodezike dy-dimensionale (gjerësia, gjatësia) do të jenë të disponueshme.

IV. Identifikuesit për sistemet koordinative referencë

Identifikuesit e sistemeve koordinative referencë

1. Parametrat dhe identifikuesit e sistemit koordinativ referencë do të menaxhohen në një ose disa regjistra të përbashkët për sistemet koordinative referencë.
2. Vetëm identifikuesit që përmban një regjistër i përbashkët do të përdoren për referimin tek sistemet koordinative referencë të listuara në këtë seksion.
3. Identifikuesit e listuar në tabelën 2 do të përdoren për referimin tek sistemet koordinative referencë të përdorura në një grup të dhënash.



Këto udhëzuese teknike propozojnë përdorimin e http URI-të të ofruara nga Open Geospatial Consortium si identifikues të sistemit koordinativ referencë (shiko identifikuesit për CRS-të standard më poshtë). Këto janë të bazuara dhe të drejtojnë tek përkufizimi në regjistrin e parametrave gjeodezik EPSG (<http://www.epsg-registry.org/>).

Shënim: Identifikuesit e CRS mund të përdoren prsh në:

- Kodimin e të dhënave,
- Metadatat e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave, dhe
- Kërkesat për shërbimet e rrjetit të INSPIRE.

Tabela 2. http URI-të për sistemet koordinative referencë standard:

Sistemi koordinativ referencë	Shkurtimi	Identifikuesi http URI
Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare. ETRS89/ Abania	KRGJSH	http://www.epsg-registry.org/export.htm?gml=urn:ogc:def:crs:EPSG::6870
Kartezian 3D në ETRS89	ETRS89-XYZ	http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/4936
Gjeodezike 3D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-GRS80h	http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/4937
Gjeodezike 2D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-GRS80	http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/4258
Projeksion LAEA 2D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-LAEA	http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/3035
Projeksion LCC 2D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-LCC	http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/3034
Projeksion TM 2D në ETRS89 mbi GRS80, zona 34N (18°E deri 24°E)	ETRS89-TM34N	http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/3046
Lartësi në EVRS	EVRS	http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/5730
3D të kombinuara: Gjeodezike 2D në ETRS89 mbi GRS80, dhe lartësitë EVRS	ETRS89-GRS80-EVRS	http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/7409

C. Sistemet e referencës kohore

Sistemet e referencës kohore

Sistemi standard i referencës kohore i caktuar në pikën 5, Kreu II të VKM-së nr. 1077, datë 23.12.2015 “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”. do të përdoret, përveç rastit kur janë caktuar sisteme koordinative të referencës kohore të tjera për tema të të dhënave gjeohapësinore specifike në ligjin 72/2012.



Shënim 1: Pika 5 e Kreut II të VKM-së nr. 1077, datë 23.12.2015 “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë” thekson që sistemi standard referencë do të jetë kalendari Gregorian, me datat e shprehura në përputhje me ISO 8601.

Shënim 2: ISO 8601 *Elementet e të dhënave dhe formatet e shkëmbimit – Shkëmbimi i informacionit – Pasqyrimi i datës dhe orës* është një standard ndërkombëtar që mbulon shkëmbimin e të dhënave të lidhura datën dhe orën. Qëllimi i këtij standardi është që të sigurojë një metodë të qartë dhe të mirë-përcaktuar për pasqyrimin e datës dhe orës, në mënyrë që të shmangen keqinterpretimet e pasqyrimeve numerike të datës dhe orës, veçanërisht kur të dhënat transmetohen ndërmjet shteteve me konventa të ndryshme për shkrimin numerik të datës dhe orës. Standardi organizon të dhënat në mënyrë që afati më i madh i kohor(viti) shfaqet fillimisht në të dhëna varg dhe vazhdon deri te afati më i vogël kohor (sekondi). Ajo gjithashtu ofron një metodë të standardizuar për komunikimin informacionit të bazuar në kohë ndërmjet zonave kohore duke i dhënë një spostim të Kohës Universale të Koordinuar (UTC).

Shembull: 1997 (viti 1997); 1997-07-16 (16 Korrik 1997); 1997-07-16T 19:20:30+01:00 (16 Korrik 1997, 19^{ore} 20^{min} 30^{sek}, zona kohore UTC+1).

D. Njësitë e matjeve

Kërkesa dhe rregulla të tjera

Të gjitha vlerat e matjeve duhet të shprehen nëpërmjet njësive SI ose jo-SI të pranuar për përdorim me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive, përveç kur specifikohet ndryshe për tema apo tipe specifike të të dhënave gjeohapësinore.

3.1.6. CILËSIA E TË DHËNAVE.

Ky kapitull përfshin një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementëve dhe nën elementëve si dhe cilësinë e matjes së të dhënave, që duhen përdorur për të vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e të dhënave për grupet e të dhënave që lidhen me të dhënat gjeohapësinore të temës Emërtimet gjeografike.

Kërkesë

Saktësia e materialeve hartografike, të cilat lidhen me tipologjinë e temës Emërtimet Gjeografike, duhet të plotësojnë saktësinë ekzistuese të krijimit të këtyre materialeve, deri në momentin e krijimit dhe përcaktimit të saktësisë së Hartës për Kadastrën Multifunkionale. Ndërsa harta bazë për elementët e rinj që do të krijohen, do të jetë produkti hartografik që do të krijohet nga projekti i Fotografimit Ajror i vitit 2015.

Cilësia e të dhënave të elementëve, nën-elementëve dhe matjeve duhet të përdoret për të:

- Specifikuar kërkesat apo rekomandimet lidhur me cilësinë e të dhënave të rezultateve të aplikueshme për grupet e të dhënave që lidhen me të dhënat gjeohapësinore për temën Emërtimet gjeografike
- Vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e elementëve të metadatave të të dhënave të grupeve të të dhënave.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të gjithë kërkesat për cilësinë e të dhënave të elementëve dhe nën elementëve që përmenden në këtë standard. Informacioni i cilësisë së të dhënave vlerësohet në nivelin e objekteve gjeohapësinore, llojet e objekteve gjeohapësinore, grupet e të dhënave dhe seritë e grupeve.

Rekomandim:

Ku është e pamundur për të shprehur vlerësimin e një elementi të cilësisë së të dhënave në mënyrë sasiore, vlerësimi i elementit duhet të shprehet me një deklaratë tekstuale si rezultat përshkruar i cilësisë së të dhënave.

3.1.6.1. ELEMENTËT E CILËSISË SË TË DHËNAVE:

Pjesa	Elementi i cilësisë së të dhënave	Nën-elementi i cilësisë së të dhënave	Përkufizimi	Sfera e vlerësimit
3.1.6.1.1	Kompletimi	Përfshirja	Të dhënat e përjashtuara nga grupi i të dhënave, siç përshkruhen nga objekti i fushëveprimit.	Tipi i objekt gjeohapësinor
3.1.6.1.2	Përputhja logjike	Përputhja konceptuale	Zbatimi i rregullave të skemës konceptuale	Tipi i objektit gjeohapësinor; objekti gjeohapësinor
3.1.6.1.3	Përputhja logjike	Përputhja e domain-it ³	Zbatimi i vlerave të fushave të domain-it	Lloji i objektit gjeohapësinor; objekti gjeohapësinor

³ Domain – kuptimi në dokumentin “Rregullat e ndërveprshmërinë së të dhënave, grupeve të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore”



3.1.6.1.4	Saktësia pozicionale	Saktësi absolute ose e jashtme	Afrimi me vlerat e koordinatave të raportuara të pranuar si të vërteta ose të vërteta	Objekt gjeohapësinor
-----------	----------------------	--------------------------------	---	----------------------

3.1.6.1.1. KOMPLETUAR – PËRJASHTIMI. (COMPLETENESS – OMISSION)

Rekomandim:

Përfashtimi duhet të vlerësohet dhe të dokumentohet duke përdorur normën e artikujve të tepërt të përcaktuara në tabelat e mëposhtme.

Emri	Norma e artikujve të tepërt
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Kompletimi
Cilësia e të dhënave të nën-elementëve	Përfashtimi
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizim	Numri i artikujve të hequr në grupin e të dhënave në lidhje me numrin e artikujve që duhet të ishin të pranishëm.
Përshkrim	-
Fusha vlerësimit	Tipi i objektit gjeohapësinor/ grupet e të dhënave
Fusha raportimit	Grupet e të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Integer
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	-
Burimi referencë	Bazat e të dhënave që përmbajnë objekte të adresueshme.
Shembull	
Masa identifikuese	10

3.1.6.1.2. PËRPUTHJA LIGJORE – PËRPUTHJA KONCEPTUALE. (LOGICAL CONSISTENCY – CONCEPTUAL CONSISTENCY)

Rekomandim:

Për testimet mbi përputhjen konceptuale, rekomandohet përdorimi i nën-elementit të cilësisë së të dhënave të ‘Përputhja logjike– Përputhja konceptuale’ dhe masat e ‘Numri i artikujve jo në përputhje me rregullat e skemës konceptuale’, të përcaktuara në tabelat e mëposhtme:

Emri	Numri i artikujve jo në përputhje me rregullat e skemës konceptuale
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Përputhja ligjore
Cilësia e të dhënave të nën-elementëve	Përputhja konceptuale
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Numri i gabimit
Përkufizim	Numërimin e të gjithë artikujve në grupet e të dhënave të cilat nuk janë në përputhje me rregullat e skemës konceptuale.
Përshkrim	Nëse skema konceptuale në mënyrë të qartë përshkruan rregullat, këto rregulla do të ndiqen. Shkeljet kundër rregullave të tilla mund të jenë, për shembull, vendosja e pavlefshme e tipologjive brenda një tolerancë të caktuar, dublikimi i elementëve dhe mbivendosjet të pavlefshme të tyre.



Fusha vlerësimit	Objektet gjeohapësinore / tipet e objekteve gjeohapësinore
Fusha raportimit	Grupet e të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Integer
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	-
Burimi referencë	ISO/DIS 19157 Geographic information – Data quality
Shembull	-
Masa identifikuese	10

3.1.6.1.3. PËRPTHJA LOGJIKE – PËRPTHJA E DOMAIN-IT. (LOGICAL CONSISTENCY – DOMAIN CONSISTENCY)

Rekomandim:

Për testimet mbi përputhjen konceptuale, rekomandohet përdorimi i nënelementit të cilësisë së 'Përputhja logjike – Përputhja e domain-it' dhe masës së 'Numri i artikujve jo në përputhje me fushën e tyre të vlerave' dhe siç është specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Emri	Numri i artikujve jo në përputhje me fushën e tyre të vlerave
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Përputhja logjike
Cilësia e të dhënave të nën-elementëve	Përputhja e domain-it
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Numri i gabimit
Përkufizim	Numërimi i të gjithë artikujve në grupin e të dhënave që nuk janë në përputhje me fushën e tyre të vlerave
Përshkrim	-
Fusha vlerësimit	Objektet gjeohapësinore / tipet e objekteve gjeohapësinore
Fusha raportimit	Grupet e të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Integer

3.1.6.1.4. SAKTËSIA E POZICIONIMIT – SAKTËSIA ABSOLUTE APO E JASHTME. (ABSOLUTE OR EXTERNAL ACCURACY)

Rekomandim:

Saktësia absolute ose e jashtme duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur saktësinë absolute pozicionale ose saktësinë e jashtme të nën-elementeve dhe vlerën mesatare të pasigurive pozicionale siç është specifikuar në tabelën më poshtë.

Emri	Vlera mesatare e gabimit pozicional(1D,2D)
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Saktësia e pozicionimit.
Cilësia e të dhënave të nën-elementëve	Saktësia e jashtme apo absolute.



Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Jo e aplikueshme
Përkufizim	Vlera mesatare e gabimit pozicional për një grup të pozicioneve ku paqartësitë pozicionale janë përcaktuar si distanca midis një pozicioni të matur dhe asaj çfarë është konsideruar si pozicioni i vërtetë përkatës. Saktësia horizontale⁴ $GMK_x = \sqrt{\sum (x_{Edhënë,i} - x_{Ekontrolluar,i})^2 / n}$ $GMK_y = \sqrt{\sum (y_{Edhënë,i} - y_{Ekontrolluar,i})^2 / n}$ ku: $x_{Edhënë,i}$, $y_{Edhënë,i}$ – janë koordinatat horizontale e pikave të kontrolluara në grupin e të dhënave. $x_{Ekontrolluar,i}$, $y_{Ekontrolluar,i}$ – janë koordinatat e pikave të kontrolluara nga burime të pa varuara të një saktësie më të lartë n – është numri i pikave të testuara i – është numri përkatës i pikes. Gabimi horizontal i pikës përcaktohet nga: $GMK_r = \sqrt{\sum ((x_{Edhënë,i} - x_{Ekontrolluar,i})^2 + (y_{Edhënë,i} - y_{Ekontrolluar,i})^2) / n}$ $GMK_r = \sqrt{GMK_x^2 + GMK_y^2}$ Nëse nga llogaritjet kemi $GMK_x = GMK_y$, $GMK_r = \sqrt{2 * GMK_x^2} = \sqrt{2 * GMK_y^2}$ $GMK_r = 1,4142 * GMK_x = 1,4142 * GMK_y$ Supozohet sikur gabimet sistematike janë eliminuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Nëse gabimet janë të shpërndara në mënyrë normale dhe të pavaruara në secilin komponent (x, z) një koeficient (faktor) 2,4477 përdoret për të llogaritur saktësinë horizontale me nivel besimi 95% (Greenwalt and Schultz 1968). Kur zbatohen kushtet e mësipërme, $GMK_x = GMK_y$, vlera e saktësisë horizontale referuar NSSDA duhet të llogaritet nga formula: $Saktësia_r = 2,4477 * GMK_x = 2,4477 * GMK_y$ $Saktësia_r = 2,4477 * GMK_r / 1,4142$ $Saktësia_r = 1,7308 * GMK_r$
Përshkrim	

⁴Shiko “Standardin kombëtar për raportimin e saktësisë së të dhënave gjeohapësinore”



Fusha vlerësimit	Objektet gjeohapësinore / tipet e objekteve gjeohapësinore
Fusha raportimit	Grupet e të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Matje
Cilësia e të dhënave të strukturës të vlerave	-
Burimi referencë	ISO/DIS 19157 Geographic information – Data quality
Shembull	
Masa identifikuese	28



4. ANEKSE

4.1. KATALOGU I TIPOLOGJIVE

Nr	Emri i elementit Anglisht	Emri i elementit Shqip	Tema	Tipi
Emërtimet Gjeografike				
3.1.4.1	GeographicalName	EmërtimetGjeografike	Geographical Names	«dataType»
3.1.4.2	NamedPlaced	EmërtimiI Vëndit	Geographical Names	«featureType»
3.1.4.3	SpellingOfName	GermëzimiIEmrit	Geographical Names	«dataType»
3.1.4.5	PronunciationOfName	ShqiptimiIEmrit	Geographical Names	«dataType»
3.1.4.6	NamedPlaceTypeValue	VleraELlojitTëEmërtimitTëVëndit	Geographical Names	«CodListe»
3.1.4.7	GrammaticalNumberValue	VleraENumritGramatikor	Geographical Names	«CodListe»
3.1.4.8	NameStatusValue	VleraEStatusitTëEmrit	Geographical Names	«CodListe»
3.1.4.9	GrammaticalGenderValue	VleraEGjinisëGramatikore	Geographical Names	«CodListe»
ANEKSE				
A	Identifier	Identifikues	Generic Conceptual Model	«dataType» imported

4.2. TË DHËNAT E IMPORTUARA

A. Identifikues – (Identifier) - DataType

KodiIshtetit		
	Përkufizim	Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga organi përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit gjeohapësinor.
	Paketa	Base Type
	Referenca	INSPIRE Generic Conceptual Model, version 3.4 [DS-D2.5]
	Përshkrim	-



4.3. KODI EPSG PER KRGJSH



**International Association of
Oil and Gas Producers**
EPSG geodetic parameters
data set version 8.5.4



**Detailed Report on Projected
Coordinate Reference Systems**
Search Criteria: 6870

1 Code: 6870 Name: ETRS89 / Albania 2010
Albania alternative identifier: KRGJSH-2010

Base GeogCRS: ETRS89

Geodetic Datum: European Terrestrial Reference System 1989

Ellipsoid: GRS 1980

Semi-major axis (a) = 6378137 metre

Inverse flattening (1/f) = 298.257222101

Prime Meridian: Greenwich

Datum origin: Fixed to the stable part of the Eurasian continental plate and consistent with ITRS at the epoch 1989.0.

Datum remarks: The distinction in usage between ETRF89 and ETRS89 is confused: although in principle conceptually different in practice both are used for the realisation.

CRS scope: Large and medium scale topographic mapping, cadastral and engineering survey.

CRS remarks: Planimetric component of Albanian Geodetic Reference Framework (KRGJSH) 2010.

CS axes:

Order	Axis Name	Abbr	Axis Units	Orientation
1	Northing	X	metre	north
2	Eastings	Y	metre	east

CS remarks: Used in projected and engineering coordinate reference systems.

Map Projection: Albania 2010

Projection Method: Transverse Mercator

Parameter Name	Parameter Value	Unit of Measure
Latitude of natural origin	0 ° 0' 0 "	N
Longitude of natural origin	20 ° 0' 0 "	E
Scale factor at natural origin	1	unity
False easting	500000	metre
False northing	0	metre

Projection remarks: Planimetric component of Albanian Geodetic Reference Framework (KRGJSH) 2010.

CRS info, source: State Authority for Geospatial Information (ASIG).

CRS area of use: 3212 Albania - onshore.

Data source: OGP

Revision date: 18-Sep-14

Change id: 2014.008 2014.065

EPSG geodesy parameters. Version: 8.5.4 of 18 September 2014

Projected Coordinate Reference Systems (detailed)

Printed on: 28-Oct-14 Page 1 of 1